
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)****OPERATORIT EKONOMIK “ARGENT DACI” PF NUIS L01914003T**

Adresa: Tirane Kamez Rruga Abdi Bej Toptani, godina nr.21, poshte ktheses se Valiasit

Procedura e prokurimit/lotit: Proçedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar (mall) marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti VI “Blerje mish viçi për IEVP-të e Sistemit të Burgjeve”, me Nr. **REF-20171-09-17-2024** për nevoja të Drejtorisë së Burgjeve. (për 20 IEVP-të sipas përcaktimit në pikën 2.12 të dokumentave standarte të tenderit)

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 48 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Afat i lëvrimit/dorëzimit të mallit do të bëhet nga lidhja e kontratës/ kontratave nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në bazë të kërkesave dhe nevojave të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale sipas përcaktimit në pikën 2.9 të DST.

Lëvrimi i mallit do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme në magazinat e tyre sipas kërkesës së cdo IEVP-je në varësi të numrit të të dënuarve, forcës ditore, normativave ligjore. Me lidhjen e kontratës brenda specifikimeve teknike do të saktësohen edhe sasi të përkatëse si edhe mënyra e furnizimit për çdo IEVP.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 63 datë 23 Shtator 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës së sipërcituar:

1. Operatori ekonomik “ARGENT DACI” PF

NUIS L01914003T

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në fazat e tjera të procedurës së sipërcituar këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “ARGENT DACI” PF

NUIS L01914003T

Vlera e ofertës pa tvsh = 591,685,148 (pesëqind e nëntëdhjetë e një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH.

Lista e operatorëve ekonomikë të s’kualifikuar:

1 Operatori ekonomik “KAZAZI - MEAT” shpk

NUIS K73609801E

Ky operator ekonomik është s’kualifikuar në fazën e parë atë parakualifikuese për arsyt si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik pjesëmarrës referuar dokumentacionit të paraqitur, nuk përmbush kërkesat për kualifikim, përcaktuar në pikën 2.3.1, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, të përcaktuara në DT, lidhur me: “Furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit të këtij loti”, për këto asrye:

Në zbatim të kërkesave të vecanta për kualifikim pika 2.3.1, subjekti duhet të vërtetonte furnizime të ngjashme në një vlerë jo më vogël se 40% e Fondit Limit ($40\% \times 592,016,925.38 = \underline{\underline{236,806,770 \text{ lekë pa tvsh}}}$). Nga shqyrtimi i faturave tatimore të shitjes të paraqitura, rezultoi se subjekti KAZAZI MEAT sh.p.k nuk plotëson vlerën e kërkuar për kualifikim, pasi vlera kryesore e faturave të paraqitura i përket kategorive 1. Mish pule i përpunuar ne formën (fileto e marinuar) 2. Salcice, kremvicet dhe nenproduktet e tjera të sallamerie, të cilat nuk vlerësohen si furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit “Mish Vici”.

Operatori ekonomik ka paraqitur faturat dhe vlerat e realizuara për këto zëra:

- Fatura me Mish vici, qingji = 75,821,412 Leke pa tvsh).
- Fatura me Mish pule (80% fileto pule e marinuar) = 149,315,897 Leke pa tvsh

Ndërsa faturat për salcice, kremvice dhe produkte të tjera sallamerie dhe artikuj pa lidhje me mishin janë paraqitur:

- Fatura me salcice , produkte të përpunuara sallamerie etj = 127,361,051 Leke pa tvsh
- Fatura me artikuj pa lidhje me mishin = 1,759,999 Lekë pa tvsh

Në bazë të këtyre treguesve, vlera e ngjashme e furnizimit me “Mish Vici/Qingji realizuar nga operatori pjesëmarrës është 75,821,412 lekë pa TVSH, e cila është me e vogël se vlera e kërkuar prej 236,806,770 lekë pa TVSH).

Shënim: Gjate analizes së dokumenteve të paraqitura, u vu re se nga faturat e dorezuara 582 prej tyre ishin fatura te ANULLUARA, te cilat nuk jane me te vlefshme fiskalisht. Gjithashtu u vu se nga faturat e dorezuara 907 prej tyre ishin fatura te DUBLUARA, pra fatura te caktuara paraqiteshin me shume se 1 here, te cilat normalisht ne llogaritje u moren vetem 1 here. (Për këtë arsye në vlerat e mësipërme nuk janë llogaritur faturat e dubluara dhe faturat e anuluarat me vlerë negative që rezultuan nga shqyrtimi)

Argumentat mbi vlerësimin se furnizimet me objekt “shitje mishi gjedh apo të imta” nuk janë të ngjashme me furnizime me objekt “mish pule të përpunuar dhe produkte sallamerie”:

Në analizë të natyrës dhe karakteristikave të produkteve ushqimore të realizuara nga operatori ekonomik KVO vlerësoi dhe gjykoj se faturat tatimore të shitjes të paraqitura nga KAZAZI MEAT, për furnizimet 1. Mish Pule 2. Prodhime te ndryshme sallamerie, nuk plotësojnë kushtet si eksperiencë e ngjashme me objektin e prokurimit për këto arsye:

Ne këtë procedurë prokurimi, nga Autoriteti Kontraktor përkatësisht Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kërkohet furnizim me “Mish viçi” që sipas specifikimeve teknike te shpallura nga AK (nënkupton “mishin e freskët dhe i papëpunuar” që përfitohet nga therja e kafshëve të gjalla stazhionuar sipas standartit shtetëror në fuqi). Objekti i prokurimit përbën një produkt ushqimor specifik, që lidhet me cilësinë dhe vlerat e larta ushqimore të produktit dhe që kërkon kapacitete të vecanta teknike në sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm për Autoritetin Kontraktor. Në funksion të këtij qëllimi, subjekti pjesëmarrës duhet të vërtetonte përvoja të mëparëshme kryesisht me realizimin e kontratave të shitjes të mishit me prejardhje nga kafshët e gjalla(mish gjedh ose bageti te imta) të ngjashme me objektin e prokurimit. Duke analizuar natyrën e produkteve, dhe kompleksitetin e furnizimit, **kategoritë e produkteve të përpunuara të industrisë së mishit, (mish fileto pule dhe nenprodukte te tjera sallamerie), të paraqitura si furnizime të ngjashme nga KAZAZI MEAT, nuk përbëjnë furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit.** Vlera e ngjashme e furnizimit me “Mish Vici/Qingji” realizuar nga operatori pjesmarrës KAZAZI MEAT rezultoi disa herë me e vogël se vlera e kërkuar për kualifikim sipas pikës 2.3.1 kapaciteti Teknik ose në vlerë absolute 75,821,412 Leke pa tvsh.

Furnizimet me objekt shitje të produkteve të sallamit dhe pulës të paraqitura, nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit pasi rezultojnë produkte mishi të përpunuara dhe jo mishi të freskët. Në lidhje me kategorizimin dhe përkufizimet e produkteve të mishit të freskët dhe të përpunuar i jemi referuar disa akteve nënligjore në fuqi ku mund të përmendim:

Udhëzimi i MBZHR nr 17 datë 24.9.2021,

Pika 2/g: “Mish i freskët” është mish i që nuk i është nënshtruar asnjë procesi ruajtjeje përveç ftohjes, ngrirjes ose ngrirjes së shpejtë, duke përfshirë mishin e paketuar në vakum ose që është paketuar në atmosferë të kontrolluar;

Udhëzimit MBZHR nr. 22, datë 25.11.2010, pika 4, shkronja h), parashikohet: h) “Përpunim” është çdo veprim që provokon një modifikim thelbësor të produktit fillestar, duke përfshirë trajtimin termik, tymosjen, kripëzimin, stazhonimin, tharjen, marinimin, ekstraktimin, shtrydhjen apo një kombinim të këtyre proceseve.

Referuar përkufizimeve ligjore rregullatore dhe faturave tatimore të paraqitura nga subjekti pjesëmarrës në shqyrtim, rezulton se faturat e realizuara për produktet salçiçe, kremviçe, fileto pule e marinuar dhe nënproduktet e tjera të sallamerisë nuk mund të konsiderohen të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit “Mish viçi”, pasi sallami dhe mishi i pulës i përpunuar janë produkte të transformuara, të përpunuara që vijnë pas modifikimit të mishit, ndërsa “Mish i viçit” që kërkohet nga Drejtoria Burgjeve, është mishi që nuk i është nënshtruar asnjë procesi tjetër dhe ka destinacionin për përdorim të drejtpërdrejtë për gatim.

Furnizimet me mish pule të përpunuar gjithashtu nuk janë furnizime të ngjashme me mishin e vicit, Mishi i viçit është mish i kuq, kurse mishi i pulës është mish i bardhë, dhe ka ndryshime midis rrjeteve të furnizimit me kafshë të gjalla me rrjetet e furnizimit me pula të gjalla për prodhim mishi, ku padyshim sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm të mishit të viçit është më i vështirë dhe kërkon kapacitete më të larta teknike (personel e njohuri të fushës, njohje dhe lidhje me tregjet e kafshëve të gjalla, besueshmëri financiare) nga subjektet furnizuese. **Në këtë kuptim një operator ekonomik që sjell si përvojë të mëparshme të dhëna për furnizime me mish pule të përpunuar (për të plotësuar kriterin bazik të furnizimeve të ngjashme) nuk përbën garanci se ka aftësi/fuqi/reputacion/besueshmëri që mund të realizojë kontratën për furnizim me mish viçi të freskët.**

Sallami si kategori nënprodukt i mishit, dhe mishi i pulës i përpunuar nuk kanë në asnjë rast cilësinë dhe vlerat ushqimore të mishit të freskët dhe nuk mund të përdoret si produkt zëvendësues i mishit të freskët për nevoja të kontratës të shpallur dhe nuk janë kërkuar për furnizim nga Autoriteti Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Kapacitetet teknike të kufizuara të subjekti pjesëmarrës për realizimin e kontratës së furnizimit me mish (**mosplotësimi i vlerës së kërkuar për furnizime të ngjashme me mish të freskët të papërpunuar**), konfirmohen edhe referuar licenses Kodi II.1.A.1; LN-4949-04-2018, të KAZAZI MEAT, ku pjesën kryesore të aktivitetit e ka të mbështetur në “përpunimin e mishit” që lidhen me produktet e mishit të përpunuara si sallam, suxhuk, kremvice, fileto pule të marinuara, të cilat sikurse argumentuam më sipër nuk janë produkte të ngjashme me objektin e prokurimit.

2. Operatori ekonomik “FRIGO FOOD” sh.p.k

NUIS J91501001C

Ky operator ekonomik është s’kualifikuar në fazën e parë atë parakualifikuese për arsyet si më poshtë vijon:

Referuar dokumentacionit të paraqitur vlerësohet se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit për këto arsye:

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3, të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, pasi nuk disponon Liçensës të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” (e vlefshme), për stabilimentin ku të përcaktohet qartë fusha e veprimtarisë sipas objektit të prokurimit (Lotit VI), kërkesë thelbësore për kualifikim përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në këtë procedurë prokurimi.

Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.2.2, të seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT ku kishte detyrimin të paraqesë kopje

të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Pasqyrat financiare për vitet 2021,2022,2023 të nënshkruara dhe vulosura nga përfaqësuesi ligjor subjekti nuk janë çertifikuara nga autoritetet tatimore përkatëse.

3. Operatori ekonomik “DEKON FRIGO” sh.p.k

NUIS K73005207B

Ky operator ekonomik është s’kualifikuar në fazën e parë atë parakualifikuese për arsyet si më poshtë vijon:

Referuar dokumentacionit të paraqitur vlerësohet se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit për këto arsye:

- I. Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.2.2, të seksionit 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT mbi detyrimin të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Pasqyrat financiare për vitet 2021,2022,2023 të nënshkruara dhe vulosura nga përfaqësuesi ligjor subjekti nuk janë çertifikuara nga autoritetet tatimore përkatëse.
- II. Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesat sipas pikës 1 germa a) të Kërkesave të Veçanta për Kualifikim Shtojca 9 e DT, pasi nuk paraqiti sigurimin e ofertës.
- III. Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.4, të seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT pasi Deklarata për kontrollin e fundit të AKU nuk është dorëzuar si dokument në sistem elektronik të prokurimit.
- IV. Operatori ekonomik nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.5, të seksionit 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT , pasi nuk paraqiti dokumentin mbi certifikimin SH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

4. Operatori ekonomik “HYSNI TAFA”P.f

NUIS : K63027805P

Ky operator ekonomik është s’kualifikuar në fazën e parë atë parakualifikuese për arsyet si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik ka kryer logim në SPE duke ngarkuar vetëm 3 dokumente elektronike të cilat nuk plotësojnë asnjë nga Kërkesat e Përgjithshme dhe të Veçanta për kualifikim të kërkuara në DT.

Mbas këtij klasifikimi të bërë në fazën parakualifikuese referuar nenit 97 pika 3 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar u realizua pritja e ankesave për vlerësimin e bërë në mbylljen e fazës parakualifikuese.

Gjatë pritjes së ankesave lidhur me këtë fazë u paraqit një ankesë lidhur me vlerësimin e kryer nga operatori ekonomik pjesëmarrës i s’kualifikuar “KAZAZI -MEAT” shpk. Mbas shqyrtimit edhe trajtimit të kësaj ankese si nga ana e KSHA pranë Autoritetit Kontraktor ashtu edhe nga ana e KPP - së e shprehur me vendim Nr.399/2025 u vendos lënia në fuqi e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave . Me marrjen e këtij vendimi si edhe me lejimin e vijimit të hapave të

mëtejshme procedurale nga ana e Autoritetit Kontraktor u vijua procedura për fazën e dytë me dergimin e ftesës pranë Operatorit ekonomik “Argent Daci” pf për paraqitjen e ofertës ekonomike. Hapja e ofertës ekonomik u krye nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në dt 07.04.2025 ora 11.00.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjatë hapjes së ofertave ekonomike konstatoi se ishte paraqitur operator ekonomik përkatësisht si më poshtë vijon:

1.Operatori ekonomik “ARGENT DACI” PF

NUIS L01914003T

Vlera e ofertës pa tvsh = 591,685,148 (pesëqind e nëntëdhjetë e një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH.

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operator ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si i suksesshëm:

1. Operatori ekonomik “ARGENT DACI” PF

NUIS L01914003T

Vlera e ofertës pa tvsh = 591,685,148 (pesëqind e nëntëdhjetë e një milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.